

**Statuti**  
**i Shoqerise Tregetare Anonime**  
**“ONUFRITV1”**

Ne perputhje me ligjin nr.7638\ 19.11.1992 “Per shoqerite tregetare” nr.8410\ 30.09.1998 “Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise” aksioneret e meposhtem:

- Naun Mihal Shtrepi lindur dhe banues ne Berat dtl.1958
- Fatmir Qamil Koçi lindur ne Korçe dhe banues ne Berat dtl.1961
- Saimir Baki Likollari lindur dhe banues ne Berat dtl.1975
- Eduart Isuf Kasemi lindur dhe banues ne Berat dtl.1975
- Bardhyl Kodhel Islami lindur dhe banues ne Kucove dtl.1960
- Kastriot Kadri Lutaj lindur ne Vlore dhe banues ne Kucove dtl.1956.

**Kreu i I-re**

*Emri, Selia, Objekti.*

**Neni 1**

Emir i shoqerise tregetare anonime eshte “ONUFRITV1”Sh.A.

**Neni 2**

Selia e shoqerise eshte Lagja:“10-Koriku”, Pallati i oficerave,Berat.



*(Handwritten signatures)*

### Neni 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

Prodhimi, transmetimi dhe ritransmetimi i programeve me karakter informativ, edukativ, kulturor, artistik, argetues dhe reklamues qe transmetohen me vale nga stacioni televiziv "ONUFRI TV1".

### Kreu i II


#### Kapitali i shoqerise

### Neni 4

Kapitali themelues i shoqerise eshte 10.000.000 (dhjete milione) leke i cili perbehet nga kontributi i aksionereve themelues si me poshte:

- Fatmir Qamil Koçi 36% ose 3600 aksione.
- Naun Mihal Shtrepi 28% ose 2800 aksione.
- Saimir Baki Likollari 28% ose 2800 aksione.
- Eduart Isuf Kasemi 4% ose 400 aksione.
- Bardhyl Kodhel Islami 2% ose 200 aksione.
- Kastriot Kadri Lutaj 2% ose 200 aksione.

Kapitali i shoqerise ndahet ne aksione te cilat jane aksione nominative me vlere nominale 1000 leke per çdo aksion.



## Kreu III

### Organet e shoqerise

#### Neni 5

Organet e shoqerise jane:

1. Asambleja e aksionereve.
2. Keshilli mbikqyres.
3. Drejtori.

#### Neni 6

Keshilli mbikqyres i shoqerise perbehet nga maksimumi tre anetare te cilet zgjidhen nga Asambleja e aksionereve brenda 15 diteve nga dita e miratimit te shoqerise.

#### Neni 7

Drejtori i shoqerise "ONUFRI TV1" emerohet nga Keshilli mbikqyres brenda 15 diteve nga dita e miratimit te kesaj shoqerise ne Gjykatën kompetente.



#### Neni 8

Kompetencat e *Drejtorit* jane:

1. Perfaqeson shoqerine perpara gjithe organeve kompetente, personave fizike, juridike, vendas apo te huaj.
2. Shqyrton administrimin dhe shpenzimet e shoqerise.
3. I propozon Keshillit mbikqyres per miratim aktin e emerimit ose te pushimit nga puna te punonjesve te shoqerise.
4. I propozon Keshillit mbikqyres masen e pagave te personelit.

5. Cakton perfaqesues te posaçem me detyra te percaktuara qarte te cilet perfaqesojne shoqerine ne perobleme te veçanta.
6. Harton planin ekonomik vjetor dhe ja paraqet Asamblese per miratim ne mbledhjet e zakonshme.

## Neni 9

Ne ushtrimin e kopetencave te tij drejtori nxjerr vendime, urdhera e udhezime te detyrueshme per personelin punonjes.

Çdo ballafaqim i drejtorit me organet kompetente shteterore apo me te tretet fiksohet ne nje proces verbal, i cili nenshkruhet nga drejtori dhe shkruesi.

## Neni 10

Vendimet dhe urdherat e drejtorit duhet te shtrohen per miratim ne mbledhjen e rradhes te Keshillit mbikqyres.

## Neni 11

**Keshilli mbikqyres** ka keto kompetenca:

1. Emeron dhe shkarkon drejtorin e shoqerise.
2. I propozon Asamblese se aksionereve ndryshim te fondit te pagave si edhe ndryshimin e struktures organizative te shoqerise.
3. Ben aktin e emerimit ose te pushimit nga puna te punonjesve si edhe percakton pagat e tyre.
4. Kontrollon ne çdo kohe drejtorin per veprimtarine e tij ne administrimin e shoqerise.
5. Çdo muaj therret ne raport drejtorin e shoqerise.
6. Jo me vone se dy muaj nga mbyllja e vitit financiar, merr ne shqyrtim rraportin e bere nga drejtoria per vitin financiar ne mbyllje.

Jal out

## Neni 12

Keshilli mbikqyres zgjedh kryetarin e tij.

Keshilli mbikqyres mblidhet jo me rralle se nje here ne muaj.

Mbledhjet e Këshillit kryesohen nga Kryetari i tij.

Proçes verbali i mbledhjes se Keshillit nenshkruhet ne çdo faqe nga Kryetari dhe nga shkruesi i tij.

Çdo anetar i Keshillit mund te njihet me permbajtjen e proçes verbalit dhe te beje verejtje me shkrim per permbajtjen e tij. Ne çdo rrast verejtjet vihen ne fund te proçes verbalit dhe konsiderohen pjese e tij.

## Neni 13

Asamblea ka keto kompetenca:

1. Mblidhet jo me ralle se nje here ne tre muaj.
2. Emeron keshillin mbikqyres.
3. Cakton fondin e pagave te personelit dhe shperblimet.
4. Miraton strukturen organizative te shoqerise.
5. Emeron ekspertin kontabel.
6. Autorizon drejtorin e shoqerise per kryerjen e operacioneve ekonomike
7. Ndryshon statutin e shoqerise.
8. Ndryshon kapitalin themelues te shoqerise.
9. Mer vendime ne lidhje me bashkimin, ndarjen ose prishjen e shoqerise si edhe ne ndryshimin e saj ne nje forme tjeter ne baze te ligjit.

## Neni 14

Asambleja e aksionereve mblidhet ne seanca te jashtezakoneshme me kerkesen e jo me pake se 2/3 e Keshillit mbikqyres dhe me kerkesen e Drejtorit.

Asambleja e mbledhur ne seanca te jashtezakoneshme ka te njejta kompetenca si edhe ne mbledhjet e zakonshme te saj.



Johiart

## Neni 15

Asamblea e aksionereve i mer vendimet me pelqimin e te gjithë anetareve te saj.

## Neni 16

Çdo aksioneri duhet t'i vihet ne dispozicion dokumentacioni i mbledhjes se asamblese jo me vone se 15 dite nga dita e mbledhjes.

## Neni 17

Çdo seance e asamblese fiksohet ne nje proces-verbal ne te cilin duhet te shenohen pjesemarja e aksionereve dhe ecuria e mbledhjes. Proces-verbali i mbledhjes firmoset nga te gjithë aksioneret.

## Neni 18

Çdo anetar i seances se mbledhjes se Asamblese detyrohet te ruaje sekretet e shoqerise. Ne rast te kundert ai do te paguaje demet financiare shkaktuar shoqerise per kete shkak.

## Kreu IV

### Plani ekonomik vjetor

## Neni 19

Aktiviteti i shoqerise ndahet ne vite financiare qe zgjasin nga 1 janar deri ne 31 dhjetor. Viti i pare fillon nga dita e regjistrimit te shoqerise ne organet tatimore dhe mbaron ne 31 dhjetor 1998.

## Neni 20

Brenda muajit dhjetor te çdo viti drejtori perpilon planin ekonomik vjetor per vitin pasardhes. Ky plan i paraqitet per miratim Asamblese brenda dates 30 dhjetor te çdo viti.

Asamblea mund te mare parasysh edhe raportin e ekspertit kontabel i hartuar pamvaresisht nga plani ekonomik i drejtorit.

## Kreu V

### Kohezgjatja e shoqerise dhe likuidimi


## Neni 21

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte per nje afat 10 vjet te njepasnjeshem. Zgjatja e keti afati behet nga Asamblea jo me vone se tre muaj nga perfundimi i tij.

## Neni 22

Ne rastin e prishjes se shoqerise caktohet menjehere nje likuidator, i cili ne perfundim te detyres se tij i paraqet asamblese bilancil likujdues. Ne rast se asamblea miraton kete bilanc mer vendim per shkrirjen e shoqerise dhe shkarkon nga pergjegjesia likuidatorin.

Likuidatori emerohet nga Asamblea.



The image shows six handwritten signatures and a circular stamp. The stamp is partially visible on the left, containing the text 'K. EK' and 'K. EK'. The signatures are written in black ink on a white background.

## **Kreu VI**

### **Dispozita te fundit**

#### **Neni 23**

Çdo mosmareveshje e aksionereve duhet te diskutohet ne mbledhjen e Asamblese ne baze te statutit. Ne rast se nuk arihet mirekuptimi çdo njeri prej te interesuareve i drejtohet Gjykates se Rrethit Berat.


#### **Neni 24**

Ky statut hyn ne fuqi me miratimin e tij nga Gjykata kompetente.

*Berat me 09/12/1998*

### **AKSIONERET**


**Naun SHTREPI**

*Naun Shtrepi*  



**Saimir LIKOLLARI**

*Saimir Likollari*  



**Bardhyl ISLAMI**

*Bardhyl Islami*  



**Fatmir KOÇI**

*Fatmir Koc*  


**Eduart KASEMI**

*Eduart Kasemi*  


**Kastriot LUTAJ**

*Kastriot Lutaj*  




Republika e Shqiperise

Noter Arben NDINI


Nr. 1052/Vep.

1480

## VERTETIM

Sot me date 10/12/1998 para meje noterit publik u paraqiten personalisht 1.Naun Mihal Shterpi 2.Fatmir Qamil Koçi 3.Saimir Baki Likollari 4.Eduart Isuf Kasemi 5.Bardhyl Kodhel Islami 6.Kastriot Kadri Lutaj per identitetin e te cileve u sigurove ne baze te leternjofimitit personal dhe pasi u garantova se kane zotesi juridike dhe per te vepruar, j'ua jexova me ze te larte statutin e shoqerise tregtare anonime "ONUFRI TV1"Sh.A., i hartuar jashte kesaj zyre, aksioneret themelues e gjeten konform vullnetit te tyre te lire dhe e nenshkruan si me siper gje qe e vertetoj edhe une si noter.

**NOTER**  
**Arben NDINI**



**Akt themelimi**  
**i Shoqerise Tregetare Anonime**  
**“ONUERI TV1”**

Bazuar ne ligjin nr.7638 /19.11.1992 “Per shoqerite tregetare” dhe nr.8410 /30.09.1998 “Per radiotelevizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise” aksioneret e meposhtem:

- Naun Mihal Shtrepi lindur dhe banues ne Berat dtl.1958
- Fatmir Qamil Koçi lindur ne Korçe dhe banues ne Berat dtl.1961
- Saimir Baki Likollari lindur dhe banues ne Berat dtl.1975
- Eduart Isuf Kasemi lindur dhe banues ne Berat dtl.1975
- Bardhyl Kodhel Islami lindur dhe banues ne Kucove dtl.1960
- Kastriot Kadri Lutaj lindur ne Vlore dhe banues ne Kucove dtl.1956.

vendosen te themelojne Shoqerine Tregetare Anonime “**ONUERI TV1**”Sh.A..

**Neni 1**

Shoqeria Tregetare Anonime quhet “**ONUERI TV1**” dhe ka emertimin e shkurtuar “**ONUERI TV1**”Sh.A..

Selia e shoqerise eshte Lagja: “10-Koriku”, Pallati i oficereve, Berat.

**Neni 2**

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

Prodhimi, transmetimi dhe ritransmetimi i programeve me karakter informativ, edukativ, kulturor, artistik, argetues dhe reklamues qe transmetohen me vale nga stacioni televiziv “**ONUERI TV1**”.



Eduart

### Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte per nje afat 10 vjet te njepasnjeshem. Zgjatja e keti afati behet nga Asambleja jo me vone se tre muaj nga perfundimi i tij.

### Neni 4

Kapitali themelues i shoqerise eshte 10.000.000 (dhjete milione) leke i cili perbehet nga kontributi i aksionereve themelues si me poshte:


- Fatmir Qamil Koçi 36% ose 3600 aksione.
- Naun Mihal Shtrepi 28% ose 2800 aksione.
- Saimir Baki Likollari 28% ose 2800 aksione.
- Eduart Isuf Kasemi 4% ose 400 aksione.
- Bardhyl Kodhel Islami 2% ose 200 aksione.
- Kastriot Kadri Lutaj 2% ose 200 aksione.

Kapitali i shoqerise ndahet ne aksione te cilat jane aksione nominative me vlere nominale 1000 leke per çdo aksion.

### Neni 5

Organet e shoqerise jane:

1. Asambleja e aksionereve.
2. Keshilli mbikqyres.
3. Drejtori.



## Neni 6

Drejtori i shoqerise "ONUFRI TV1" emerohet nga Keshilli mbikqyres brenda 15 diteve nga dita e miratimit te kesaj shoqerie ne Gjykatën kompetente.

## Neni 7

Kompetencat dhe varesite e organeve te shoqerise percaktohen hollesisht ne statutin e shoqerise bazuar ne ligjin nr.7683\19.11.1992"Per shoqerite tregtare".

## Neni 8

Planet ekonomike vjetore fillojne ne 1 janar dhe perfundojne ne 31 dhjetor te çdo viti, me perjashtim te vitit te pare qe fillon ne momentin e regjistrimit te shoqerise ne Gjykatën kompetente dhe perfundon ne 31 dhjetor 1998.

## Neni 9

Brenda muajit dhjetor te çdo viti drejtori paraqet raport ne lidhje me llogarite e vitit financiar dhe perpilon planin ekonomik vjetor per vitin pasardhes. Ky plan i paraqitet per miratim Asamblese brenda dates 30 dhjetor te çdo viti.

Asamblea mund te mare parasysh edhe raportin e ekspertit kontabel i hartuar pamvaresisht nga plani ekonomik i drejtorit.

## Neni 10

Shoqeria ka te drejte te hyje ne maredhenie ekonomike financiare me persona fizike dhe juridike vendas apo te huaj mbi bazen e kontratave bazuar ne legjislacionin shqiptar.



folkuart

## Neni 11

Ne maredhenie financiare shqeria vepron me monedhen vendase, Lekun. Ajo ka te drejte te perdore edhe valuten e huaj konform legjislacionit ne fuqi.

## Neni 12

Maredheniet e shoqerise me personelin e saj do te rregullohen mbi bazen e legjislacionit te punes. Shoqeria ka te drejte te pushoje çdo punonjes te personelit nga puna per shkak te indisiplinimit ose paaftesise profesionale duke kerkuar gjithashtu edhe demshperblim per demin e shkaktuar shoqerise nga punonjesit per faj te tyre.


## Neni 13

Ne rast prishje te shoqerise, Asamblea e aksionereve cakton nje likuidator i cili ne fund te likuidimit paraqet bilancin e likuidimit.

## Neni 14

Ky akt themelimi hartohet ne kater kopje me vlere te barabarte secili.

Berat 09/12/1998



## AKSIONERET

**Naun SHTREPI**

*Naun Shtrepi*

**Saimir LIKOLLARI**

*Saimir Likollari*

**Bardhyl ISLAMI**

*Bardhyl Islami*

**Fatmir KOÇI**

*Fatmir Koci*

**Eduart KASEMI**

*Eduart Kasemi*

**Kastriot LUTAJ**

*Kastriot Lutaj*


**Republika e Shqiperise**

**Noter Arben NDINI**

**Nr.1051/ Vep.**  
*1489*

## VERTETIM

Sot me date 10/12/1998 para meje noterit publik u paraqiten personalisht 1.Naun Mihal Shterpi 2.Fatmir Qamil Koçi 3.Saimir Baki Likollari 4.Eduart Isuf Kasemi 5.Bardhyl Kodhel Islami 6.Kastriot Kadri Lutaj per identitetin e te cileve u sigurove ne baze te leternjofimit personal dhe pasi u garantova se kane zotesi juridike dhe per te vepruar, j'ua jexova me ze te larte aktin e themelimit te Shoqerise Tregetare Anonime "ONUFRI TV1"Sh.A., i hartuar jashte kesaj zyre. Aksioneret themelues e gjeten konform vullnetit te tyre te lire dhe e nenshkruan si me siper gje qe e vertetoj edhe une si noter.



**NOTER**  
**Arben NDINI**

*Arben Ndini*